REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 51/17
Date/Datum 02.03.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit **Komuna Prizren**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Visar Basha – Ekspert shqyrtues Valton Dervishi – Ekspert Teknik		
Lënda:	Ekspertiza lidhur me Ankesën Nr. **51/17** e OE **"Limit L&B"** - Prizren.		
Datë:	01.03.2017		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik të Kosovës ju njoftojmë me raportin e ekspertizës, lidhur me ankesën e parashtruar me dt: 21.02.2017 me Nr. **51/17** nga OE **"Limit L&B"** - Prizren, për shqyrtimin e lëndës **"Shenjëzimi horizontal, vertikal dhe vendosja e barrierave në rrugët e Prizrenit"** – Lot 2 me numër të prokurimit: **622/16/086/511**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Prizren (KP).**

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA PRIZREN.**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP.**
- OE ankues – **LIMIT L&B.**

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

	28.02.2017	**28.02.2017**		**01.03.2017**
Nënshkrimi i ekspertit	*Data e autorizimit të eksp.*	*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën 21.02.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. 435/16 e parashtruar nga OE **"Limit L&B"**, me seli në Prizren, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Shenjëzimi horizontal, vertikal dhe vendosja e barrierave në rrugët e Prizrenit"** – Lot 2 me numër të prokurimit: **622/16/086/511**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Prizren (KP).** Konform nenit 113 te Ligjit Nr. 04/L-042, Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Komunës së Prizrenit (KP).**

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues "Limit L&B", me seli në Prishtinë.

Pikat e Ankesës nga OE **"Limit L&B"** *- dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

Neni 33 pika 3 dhe neni 51 pika 2.
Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
Neni 7 Barazia ne trajtim/ jo-diskriminimi;
Neni 71 Grupi i OE-ve;
Neni 13.4 Përdorimi i gjuhëve;
Neni 69 Aftësia teknike dhe Profesionale;
Neni 66 Përshtatshmëria Profesionale;
Neni 28 Specifikimi teknik;
Neni 21 Specifikimet teknike për tabelat;
Neni 6 pika 1.2 i UA;
Neni 11 Statuti i Komunës;
Neni 5 i Kushtetutës se Republikës se Kosovës.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

DEKLARATA

FAKTI 1:

Ne dosjen e tenderit te OE sinjalizimi, dokumenti me relavant, i cili ne hapje lexohet i pari, nuk eshte i neshkruar dhe nuk eshte i vulosur. (bie ndeshe me nenin 33 pika 3 dhe neni 51 pika 2)

ARGUMENTI

Dokumenti 16

Pjesa c: formulari per dorzimin e te nderit

FAKTI 2:

Shkelje e Nenit 71 pika 2 dhe 3 "Grupet e Operatorve Ekonomike dhe Operatoret e huaj Ekonomike"sipa Ligjit Nr. 04/L-042:

Në ekzaminim e dosjes origjinale të OE Sinjalizimi kemi vrejt:

- Se dokumenti 1. veprimtaria dhe pergjegjesit, që mbanë daten 30.06.2016 , nuk është origjinal , por dokument i shtypyr në shtypës color.(dok.3.);
- b) Dokumenti marrveshje konzorciumi dhe deklarata mbanë datën 01.09.2016, poashtu nuk janë në origjinal, por të shtypura në shtypës color (Dok.3, dok. 4 dhe dok. 5). Edhe vetë data në dokumente , 1.09.2016 tregon pamundsin e arritjes në Prizren, në origjinal me daten 2 shtator. Poashtu, ka lëshime ngase Deklaratat në të dy rastet ipen si grup-konzorcium, ku OE Sinjalzimi shenohet i pari, e askund nuk ka Deklarat te veçanta ose partneri të deklarohet ndaj liderit (ZMAS ndaj Sinjalizimit). (Dok.4, Dok.5 dhe Dok 6.)
- c) Aneksi 2: Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE) Partneri ZMAS SI, Deklarata nën Betim, poashtu nuk është origjinale, por e shtypur në printer color. Edhe data 01.09.2016 tregon pamundësin e arritjesë në origjinal në Prizren me 2 shtator. Njëheritë, në preambulë ka shtesë me shkronja dore, që tregon se në dokument dikush ka ndërhy. Deklarta e OE Sinkalizmi ka fonto identike me ate te Zmas, qe le per tu kuptuar se eshte vulosur ne Slloveni i eshte dergu ne e-mail ne Suharke ku eshte shkruar teskti dhe eshte shype color, pra nuk eshte origjinal.(Dok. 7. &7.2)

ARGUMENTI: Me një prove te thjeshtë me patate ose aceton verifikohet origjinalja dhe ajo e shtypur color, pa paguare ekspertize te veçantë.

FAKTI 3.

- Dokumentet e partnerit ZMAS SI, nuk jane te pasqyrueshme:
- Mungon Lista e Specifikimeve te puneve 2013, 2014 dhe 2015
- Mungon specifikimi i referencave
- Dokumentet relevante per konzorcium jane shtypur ne shtypes color dhe nuk jane origjinal.

Po ashtu ZMAS Si , dokumentacion e paraqet ne gjuhen sllovene, edhpse dihet se gjuhe zyrtare ne Republiken e Kosoves eshte gjuha shqipe e | serbishte , si dhe angleze kur kemi te bejme me konkurime dhe komunikime nderkombetare ne rajon e me gjer. Këtu kemi te bejme me shkelje te LPP , neni 13 pika 4.

ARGUMENTE: Dokumenti 23 faqe 1 deri 9.

FAKTI 4:

OE Sinjalizimi, nga aspekti aftesive teknike profesionale (neni 69 i LPP) respektivisht paisjeve është totalisht i papërgjegjshëm .

- Automjete të gjitha i ka pa regjistrue
- 04 178 DM sakdence 01.05.2016
- 04 860 FN skadence 29.04.2016
- 04989 DQ skadence 14.05.2016
- 04 784 EF skadence 28.04.2016

Si mundet te punoi me BE pa automjete , apo kemi te bejme me nje korrupsion klasik dhe evazion fiskat , ngase nuk i paguhen shtetit taksat rrugore dhe rrezikohet çdo pjesemarres ne komunikacion pavarsishet a eshte dikush rezident ne Kosove apo vizitor, me deme materiale dhe me jete. Edhe per Policin e Kosoves, kjo tregon një injoracë që i bëhet nga vet OE sinjlizimi

ARGUMENTE: Dokumentet 17 (faqe 1 deri 7)

OE SINJALIZIMI ka ofrue nje kontrate 15.03.2013 per makine per signalizimi horizontal Line Lazer 5900, ne vlere 2000 euro, qe eshte nje çmim fiktiv dhe jo ne harmoni me vlerat e tregut. Ne qarkullimin bankar te viteve 2013 , 2014 dhe 2015 nuk ka deshmi se eshte krye pagesa e makines, qe tregon fiktiviteta po shkelje te ligjit per pagesa mbi 500 eruo. Per kete transakcion nuk ka kurrfar FAKTURE qe e bene fare te dyshimte posedimin e paisjese. (Njeherit me koleget qe punojme ne branshen e signalizimit ka me kuptue se per shume pune OE Sinjalizimi i ka angazhuar ata). Pa Fature nuk ka kurrfare shitblerje, por edhe pa pagese.

ARGUMENTI: Dokumenti 22 (Nga Qarkullimi bankar, konstatohet se nuk ka pagese ne mere te makines, kontrata eshte mes vellzerve).

FAKTI 5.

Jane dy kompani qe veprojne me emra ELMI dhe MUSLI ILLUAGXHIA.

- Biznesi me nr, regj. 70789086 SINJALIZIMI sh.p.k. me pronar Musli Llugaxhiu dhe me Elmi Llugaxhija (keta jane vellezer)
- Biznesi KANJA -Dega në Kosovë me pergjegjesin Elmi Llugaxhija.

Askush në Kosovë, nga partneret me te cilet punoime ne kete bransh, nuk e njehe Muslin. E njohin vetem Elmin. Per Muslin thuhet se punon ne Slloveni dhe nuk është në Kosovë. Andai dyshojme se Elmia i nënshkruan te gjitha letrat si te done vete. Kjo mund te verifikohet edhe ne organet e rendit ne Kosove e ne Slloveni. Keta dy i nenshkruajne dhe i vulosin njeri tjetrit lloj lloj dokumenti dhe nuk mendojne se mund te pergjigjen per kete.

ARGUMENT: Dokumenti 19, faqe 1 deri 4 , te marra nga ARBK-ja Fakte te pamohuesheme: Ne Listen e Projekteve te prezentuar 2013/2014 dhe 2015 ne :

Pozoicionin 1 shenon:

Minstria ε infrastrukturese -sinjalizmi rrugeve nacionale m 2 . Data 31.01.2013 ne baze te marrveshjese date 22.12.2011: vlera 203.495.16 euro

Pozicioni 2 shenon:

Ministria e Infrastrukturese a1 -01/2013 - sinjalizm rrugeve nacionale mi 2 ... data 10.04.2013013 ne baze marrveshjese date 22.12.2011: vlera 35.518.35 euro.

Keto kontarta e as referenca nuk kane validitet.

Arsyet:

- Nuk jane te nenshkruara me Ministrin e Infrastruktures (paraqiten

te rrejshem);

- E para i perket vitit 2012
- Kompania KANJA dega ne Kosove ja neshkruan OE Sinjalizimi kontraten si nenkontraktor , pra vellau ja nenshkruan vellaut ELMIA ja nenshkruan Musliut, dhe ky e deklaron rrejshem si kontrate me Ministrine Infrastruktures.
- Qarkullimi bankar tregon se KANJA Dega ne Kosove , i paguen SINJALIZIMIT me 30.04.2013 35.671,00 euro , me 30.11.2013 3.551.84 euro dhe me 30.11.2013 3 1996.51 euro, pra gjithsejt 71.219.85 euor. Diferanca mes kontratave te paraqitura dhe pagesave bankare eshte 167.793.66 euro, pra keto nuk u paguan , respektivihst Sinjalizimi edhe nuk punoi ma shume se kjo vlere.

Në pozicionin 9

Kontrata me BE per tabela te rrugve eshte e vitit 2016, u neshkrue 15.03.2016 dhe nuk mund te hyje ne DT. Kur te hiqen kontratat fiktive te neshkruar mes vellazerve dhe keto | te vitit 2016, ateher Lista Projekteve nuk arrin as ne 170 mije eruo.

ARGUMENTE: Dokumenti 20, faqe 1 deri 20.

FAKTI 6:

OE Sinajlizimi ka ofrue Vendimin per Menaxherin dhe diplomen, por nuk ka ofrue:

- Vertetim per pervojne e punes se menaxherit, dhe
- Kontrate / marrveshje per bashkepunim ne kete projekt apo deshmi me listen e pagave

Keto dokumete kerkohen ne Dosjen e tenderti te AK-se.

ARGUMENT Dokumenti 18 (faqe 1 dhe 2).

FAKTI 7:

Qarkullimi Bankar i paraqitur nga OE Sinjalizimi, nga data 01.01.2013 deri me 31.12.2015 eshte si vijon:

- Raiffesien bank 01.01.2013-31.12.2015 11.432.92 euro
- NLB 01.01.2013 deri 31.12.2015 198.51.07 euro
- Gjithsejt: 209.943.99 euro

Kjo eshte dukshem nen kerkesat e AK-së me DT.

ARGUMENTE: Dokumenti 2 1 (faqe 1 deri 31) Qarkullimi bankar i OE Sinjalizimi, ne DT të OE Sinjalizimi.

Kemi shkelje te nenin 68 te LPP. Per anomalit ne kontrata dhe pagesa , ne jemi te shternguar te njohtoi me edhe institucionet relevante ne Republikes se Kosoves ka evazion fiskal).

ASPEKT TEKNKE-MOS TRAT:

FAKTI 7:

Shkelje e nenit 28. Specifikime teknike: pika 2.3 dhe 4 te Ligjit 04/L 042 PPP të Repulbikës së Kosovës Në ekzaminin e dosjes së OE Sinjalizimi nuk ka paraqitur mostra sipas kerkesave specifike.

ARGUMENTE:

Në Udhëzimin Administratitv nr. 11/2012 për Rendtitjen e Elementeve

- Në nenin 7, Tabelat e emërtimeve të zonave të qarkullimit pulbik, pika 2.1. shkruan
- Gjatësia e nevojshme (nga 60 cm deri në 100 cm) X gjerësia 25 cm.
- OE Sinjalizimi ka ofrue table me gjërsi 24.7 cm e jo 25 cm.

ARGUMENTI:

Dokumenti 14 (ne foto 24.7 cm)_ - b) Në nenin 7, pika 3 " Mbishkrimi përbëhet nga shkronja të mëdha me ngjyrë të bardhë, mbi sfond me ngjyrë blu dhe korniza e tabelës është me ngjyrë të bardhë".Sa i perkte foljes 3 M , te gjithe ne ne Ballkan, por edhe me giere furnizohemi nga kompania amerikane 3 M, por është me rëndsi me respektue ngjyren, proceduren e punes dhe shtypin (e jo me ngjyrosie si ka veprue OE Sinjalizimi).

OE sinjalizimi i mostrën që e ka ofrue nuk i përmbsuh kërkesat e ua 11/2012, neni 7 pika 3. ngase ks sfond me ngjyre te bardhe (e jo blute kaltert, si kerkohet) dhe ne te ka vendos ngjyre blu-te kaltert transparente dhe nuk ka mbi sfondin blu shkronja shtypi me ngjyre te bardhë.

Me këtë , oe sinjalizmi, ka bere shkelje edhe te nenit 8 : Lloji dhe madhesia e shkrimit :

NENI 8: 1. Lloji i shkrimit në labelën për emërtime është "Calibri". Shkronjat janë të printuara me një reliev me lartësi 1 mm i emri shkruhet në të dy anët e labelës.

1. 1. Lloji i ZQIP-se shkruhet ne shkurtesë në rreshtin e parë në të dy gjuhët zyrtare : RR. UL.

1.3.-Në komunat ku përdoret edhe një gjuhë e tretë Zyrtare (p.sh. Turqisht)-lloji i ZQP-së shkruhet i shkurtuar në të tre gjuhët të ndara midis tyre ne vizë të pjestrët (fig.l.-b). RR/Ul.ISK

ARGUMENTI: UA 1 l 2012 (Dok. I - faqe)

OE SINJALIZIMI , bënë shkelie të dispozitave të Udhëzimit adimistrativ 11/2012 si dhe dispozitave të Statutit të Komunë së Prizrenit . (neni i I , për giuhët zyrtare) dhe nenin 5 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (neni 5. Pika 2.)

ARGUMENTI

- Mostra e OE Sinjalizimi nuk ka sfond te kaltert. Sfondi është i bardhë, foli 3 M., dhe mbi te është e ngjyrosur me ngjyrë transparente blu-kallerte.
- Mostra e OE Sinjalizimi nuk ka shkronja te medha me ngjyre te bardhë të vendosura mbi sfondin me ngjyrë blu, pra nuk ka fare shkronja të shtypura.

- Mostra e OE Sinjalizimi nuk ka shkronja per emërtim të printuara me një reliev me lartësi 1 mm apo me e printuar dhe të ngjitura mbi sfond. Ngjyrosja me ngjyre blu-kileri transparent mbi sfondine bardhe do te demtohet per nje sezonë dhe shtresa blu do te ngritet e labela do te mbetet vetem e bardhe pa shkronja)
- Mostra e OE Sinjalizimi nuk ka shkronjat ne turqishte shkornjat SK. si kerkohet me UA, Statutin e Komunes (neni ll) dhe Kushtetuten e Repulbikes se Kosoves (neni 5.2).

ARGUMENTI:

Dokumenti 11 foto nga ekzaminimi i mostrave ne Zyren e Prokurimit.

Udhezimi administrative 13/2012 Per Vendosje Fizike te Tabelave..., neni 27 , Tabelat e grupit A pika 2.2.., shkruan" mekanizmi i saktë i vendosjesë do të propozohet nga ofertuesi".

Nga kjo shihet se as ligji e as lidhezimet administrative nuk e percaktojne formen e mekanizimit. Sa i perket shtylles, aio i mungon OF Sinializimi.

Me UA 13/2012 ne nenin 27 pika 2. 1. lidhur me shtyllen kerkohen keto karakteristika:

27.2.1 shtylla është e përbër nga një tub çelik-karboni me diameter 60 mm dhe AK , dhe 2.5mm (+/- 2 mm) trashesi te mureve.Me pergjegjsi morale e penale garantojm se askush ne Kosove ne mbi 25 Komuna ku jane vendusur tabelat nuk ka perdorus shtylla qeliku-karboni bie edhe tua e perdorur nuk kan trashesi 2.5 mm edhe vete OE sinjalizimi qe pretendon se ka perdoru kete shtylle genjen e qe mund te vertetohet duke ekzaminu shtyllen ne te cilen thirret por edhe ato qe I ka vendusur ne Komunat ku pretendon se ka punue ?

ARGUMENTI: Dokumenti 12 UA 13/2012

FAKTI 8.

Absirdoteti ma I madh qe behet ne kete rast eshte qeshtja e madhesis se shkronjave

AK, Z. Osmankaj,OE Sinjalizimi dhe eksperti teknik, thone se madhësia e shkronjave qe ne kemi dorzue ne moster jane 6 cm ??!! Dhe vertet jane 6 cm, por cilat shkronja???

Shkronjat mbi emertimin e rrugeve: rr. UL. Është 6 cm.

Emertimi rrugese "**ZAMBAKU**" eshte 7 cm.

Por kjo madhësi është e njejtë edhe te të gjithë OPERATORET EKONOMIK.

OE Sinjalizimi: Pjesa mbi emertimi te rrugës KK. është 6 cm . emertimni AZEM BEJTA eshte 7 cm

Malsia : Pjesa mbi emertim te RR./ është 6 cm, emertimi i 7 SHKURTI është 7 cm.

RSM : Pjesa mbi emërtim është RR. 5. 4 mm, emertimi eshte 7 cm.

Pra askush nuk e beri matjen e mostrave te of , por vetem te ne limit l&b e bene matien po

kurr nuk u be matia e emrtimit ZAIMI BRAll qe eshte 7 cm.

ARGUMENT:

DOK. 13. Foto nga mostrat e i IMT L& B".

DOK. 14 Foto nga mostrat e OE SINJALIZIMI.

Per te qene absurditeti edhe ma i madhe ne e kemi angazhue nje kompani qe te beje matjet ne 14 komuna,dhe ne te gjitha komunate dele se pjese e siperme rr. eshte 5.5 deri 6 cm

kurse emertimi 7 cm

ARGUMENT

Dokumenti 15 (bashkangjitur raportin nga ekspertif. 1-40)

SHTROHET PYETJA:

A do te zbatohen dispozitat e nenit 7 te LPP-se. Nese po, atëher askush në Kosovë nuk ka drejtë të shkel mbi ligjin. Nuk ka drejtë as AK-ë dhe me asnjë "alibi" nuk mundet te mbrohet e të legalizoi shkeljen e dispozitave të ligjit të cilat isnë bërë me rastin e shpalljes fituese te OE Sinjalizimit+Zmas.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP : 17.08.2016

Lloji i procedurës së aplikuar:..... Procedurë e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar: .....Punë/vlerë e madhe

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë): 02.09.2016

Data e hapjes së ofertave .....02.09.2016-14:30^{h}

Kriter për dhënie të kontratës:.....*Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët*

Lloji i kontratës:.....*Kontratë kornize – 36 muaj*

Kriteret për vlerësim

III.2)KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. Operatori ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuare në nenin 65 të LPP

A. Operatori ekonomik duhet të ketë përmbush obligimet për tatimin në pronë

B. Operatori ekonomik duhet të ketë përmbushë obligimet për taksat Komunale

C. Operatori ekonomik duhet të ketë përmbushë obligimet ndaj Administratës tatimore të Kosovës.

D. OE duhet të përmbushë obligimet ndaj sektorit për menaxhim të mbeturinave.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Një deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit.

A. Kopja e vërtetimit të tatimit në prone për periudhën e pare të vitit 2016
B. Kopja e vërtetimit për taksa komunale për periudhën e dytë 2016
C. Vërtetimi I ATK së I cili ka vlefshmëri.
D. Vërtetim nga sektori I menaxhimit të mbeturinave për muajin paraprak

Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise nën pikën A, B, C D do të kërkohen nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së njoftimit për dhënie të kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit te këtij dokumenti,tenderi në fjalë do të refuzohet.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

2 .Regjistrimi në regjistrin profesional të ndërmarrjeve

3. regjistrimi i TVSH-së

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

2. Vërtetimi nga Ministria për regjistrim-çertifikata e biznesit me llojin e veprimtarive të

regjistruara (Qertefikata e biznesit)
3. Qertefikata e TVSH së

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar

2. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i OE gjat tri viteve të fundit (2013, 2014, 2015) ka qen prej jo më pak se: për loto 1: 220.000,00 €
   Për loto 2: 980.000,00 €
   Për loto 3: 400.000,00 €

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

4 Dëshmija 1 Pasqyra e qarkullimit financiar nga një ose më shum banka, ose një dëshmi tjetër nga e cila shifet qartë se OE ka realizuar qarkullim financiar të paktën për tri vitet e fundit (2013, 2014, 2015).

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

4. Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses punë të natyrës të kontratës për tre vitet e fundit 2013, 2014, 2015 në vlerë prej
   për loto 1: 160.000,00 €
   Për loto 2: 700.000,00 €
   Për loto 3: 300.000,00 €

5. OE në kuadër të stafit duhet të emëroj menaxherin e projektit i cili duhet të jetë Ingjinjer i diplomuar i komunikacionit rrugorë ose ingjinjer i diplomuar i makinerisë me së paku tri vite pune në profesion e dëshmuar me diplomën mbi kualifikimin, vërtetimin mbi përvojën në punë, të jetë në listën e të punësuarve ose të ketë marrëveshje bashkëpunimi për këtë projekt
6. Për realizimin me sukses të këtij projekti, OE duhet të disponoj së paku me këto pajisje teknike
   a. Për loto 2 auto sinjalizues për vija të bardha nëpër rrugë
   b. Për loto 1. Autokran për intervenim në sinjalistikë

Dëshmia e kërkuar dokumentare

5. Lista me të cilën specifikohen të gjitha punimet e realizuara në tri vitet e fundit duke saktësuar punët e kryera, shumën e kontratës dhe qertefikatën për punë të mirë (Referenca të natyrës së kontratës), ose raporti i pranimit teknik të punimeve.
6. Vendimi mbi emërimin e menaxherit të projektit bashkangjitur edhe diplomën mbi kualifikimin, dëshminë mbi përvojën, kontratën e punës ose kontratën e bashkëpunimit për këtë projekt.

Lista e pajisjeve bashk me librezat valide për ato pajisje që regjistrohen kurse për pajisjet tjera dëshmi mbi pronësinë ose marrjen në shfrytëzim të pajisjeve gjegjëse.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje
1.	"Limit L&B"	Prizren	302,140.60€ LOT 2	JO
2.	"Sinjalizimi"	Suharekë	358,039.06€ LOT 2	JO

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- Fejsal Hoti - Kryetar i komisionit
- Ejup Kryeziu - Anëtar i komisionit
- Sadik Tahiri - Anëtar i komisionit.

Data e mbarimit të vlerësimit: 22.09.2016

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....22.09.2016

Data e njoftimit të Dhënies së Kontratës në faqen e Krpp-së :.....06.02.2017

Sipas raportit të komisionit të vlerësimit ofertat të PËRGJEGJSHME janë:

Nr.	Emri i tenderuesit të Përgjegjshëm	Çmimi i ofruar	Radhitja sipas çmimit
1.	Limit L&B	302,140.60€ LOT 2 80,956.00€ LOT 3	1
2.	Sinjalizimi	358,039.06€ LOT 2 169,769.00€ LOT 3	2

Raporti i komisionit vlerësues:
Komisioni ka rekomanduar për kontratë OE "Sinjalizimi".

Neni 54 i LPP-së – Njoftimi i kandidatëve - Tenderuesve

AK-ja, konform nenit 54 të LPP-së dhe nenit 37 të Udhëzuesit Operativ për Prokurimit Publik, i njofton operatorët ekonomik me letër standarde.

Neni 108/A - Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

Pas pranimit të letrës standarde OE "Limit" konform nenit 108/A ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim, me ç'rast AK-ja, e ka refuzuar ankesën e OE ankues "Limit", si te pa lejuar me arsyetimin se ky aktivitet i prokurimit është shqyrtuar me OSHP.

Përgjigjet e ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimet ankimore të OE ankues:

Sqarimi nr.1

Eksperti teknik sqaron se sa i perket pretendimit te OE ankues se nuk e ka ofruar gjeruesin e tabelës sipas kerkeses, nuk qendron per faktin se gjate ekzaminimit gjerësia e tabelës është 25 cm dhe po ashtu edhe ne foton e prezantuar dukshem verehet se gjerësia është 25 cm. Poashtu sa i përket sa i perket pretendimit te OE ankues ne lidhje me shkronjat, ngjyrën e tabelës dhe kornizën e tabelës, eksperti teknik sqaron se te dhënat ne tabelë janë sipas specifikacionit teknik.

Ne lidhje me pretendimin e OE ankues se mostra e te rekomanduarit per kontrat nuk ka sfond te kaltert, nuk ka shkronja te medha dhe nuk ka shkronja te printuara dhe se nuk ka shkronja ne gjuhen turke, eksperti teknik sqaron se keto pretendime jane te paqëndrueshme, sepse shkronjat jane sipas madhesise te kërkuara ne Udhezimin Administrativ, poashtu tabela ka sfond me ngjyr te kaltert ndersa sa i perket gjuhen ne tabel, eksperti teknik sqaron se AK-ja, ka kërkuar mostra te tabelave ndersa

gjuha ne tabel shenohet sipas kerkeses se AK-se.
Eksperti teknik, sqaron se ne lidhje me Tubin e celikut – karbonit, ku OE ankues e pranon se e ka OE i rekomanduar per kontrat e ka dorezuar sipas standardit, mirëpo ne ankes deklaron se gënjen qe do ta perdor te njejten gjate realizimit te projektit, eksperti teknik ne lidhje me kete sqaron se tubi eshte sipas standardit te UA dhe se gjate realizimit te projektit eshte kompetenc e AK-se, qe ti verifikoj.

Ne lidhje me pretendimin e OE ankues se lartësia e shkronjave ne pjesen e SIPËRME duhet te jet 5.5-6 cm, ndersa EMËRTIMI duhet te jet 7 cm, eksperti teknik pasi i ka ekzaminuar mostrat e OE te rekomanduar per kontrat, sqaron se shkronjat ne te dy pjeset e mostres kane dimensione 7 cm, sipas UA. Prandaj edhe ky pretendim është i paqëndrueshëm.

Sqarimi nr.2
Eksperti shqyrtues, lidhur me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar per kontrat nuk e ka te vulosur formularin e tenderit, sqaron se formulari eshte i vulosur dhe i nënshkruar ne fund te faqes se formularit te tenderit, prandaj ky pretendim eshte i paqendrueshem.

Lidhur me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar per kontrat nuk i ka deklaratat e themelimit te konzorciumit sipas nenit 71 te LPP-se, eksperti shqyrtues sqaron se ne oferten origjinale OE i rekomanduar per kontrat i ka tri deklaratat e vulosura dhe te nënshkruara. te parapara sipas nenit 71 te LPP-se, ndersa sa i perket pretendimit se keto deklarata jane te shtypura me shtypes kolor, eksperti shqyrtues sqaron se nënshkrimi ne dukje eshte origjinal.
Poashtu OE ankues pretendon se deklarata nen betim e anetarit te konzorciumit OE "Zmas Si", nuk eshte origjinal, por e shtypur me shtypes kolor. Eksperti shqyrtues, sqaron se deklarata nen betim eshte e plotësuar, nënshkrimi ne dukje eshte origjinal dhe e vulosur, prandaj edhe ky pretendim eshte i paqendrueshem.
Ne lidhje me dokumentet e përmendura me lart, deklaratat e themelimit te konzorciumit dhe deklaraten nen betim anetarit te konzorciumit OE te rekomanduar per kontrat, OE ankues e konteston origjinalitetin e ketyre dokumenteve i cili kerkon dhe pretendon se me ndërhyrje me patate ose aceton te vërtetohet origjinaliteti i ketyre dokumenteve.

Ne vazhdim OE ankues pretendon se dokumentet relevante te konzorciumit jane te shtypura me shtypes kolor. Eksperti shqyrtues, sqaron se OE ankues nuk e mohon ekzistencen e dokumentetacionit mirpo edhe ne kete rast dyshon qe eshte kopje dhe jo origjinal, pra me shtypes kolor.

Lidhur me pretendimin se OE ankues, nuk i ka kontrata dhe referencat per 2013, 2014 dhe 2015, eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja, ne dosje t e tnderit per Lot 2 ka kërkuar:

Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses punë të natyrës të kontratës për tre vitet e fundit 2013.2014,2015 në vlerë prej: Për loto 2: 700.000,00 €.
Eksperti shqyrtues, sqaron se ne ofert OE i rekomanduar per kontrat i ka dorezuar kontratat dhe referencat sipas kërkesës se lartpërmendur. ne ofertë gjendet një referencë me vlerë 359,040.28 euro, pastaj kontrat dhe refernc ne vler 69,960.61 euro, kontrat dhe referenc ne vler prej 290,356.93 euro, te cilat ne total kapin vleren prej 719,357.82. Vlerat e kontratave dhe referencave te lartpërmendura jane te anetarit te konzorciumit te cilat e arrin vleren e kërkuar nga AK-ja, mirëpo eksperti shqyrtues sqaron se edhe lideri i këtij konzorciumi i ka disa kontrata dhe referenca te cilat jane me vlera me te vogla. Ne lidhje me kete OE ankues pretendon se AK-ja, nuk e ka respektuar nenin 13 lidhur megjuht zyrtare, eksperti shqyrtues, sqaron se ne ofert gjendet përkthimi i dokumentacionit i nënshkruar dhe vulosur nga përkthyesi gjyqësor Isa Gjergjizi – Prizren. Prandaj ky pretendim eshte i paqendrueshem.

Sa i përket pretendimit te OE ankues ne lidhje me kater automjetet e te cilat sipas OE ankues, OE te rekomanduar per kontrat i ka te paregjistruar. Eksperti shqyrtues, sqaron se automjetet te cilat i konteston nuk jane pjes e dosjes se tenderit, pra keto automjete nuk jane kërkuar nga AK-ja, ne dosje te tenderit. Eksperti shqyrtues sqaron se AK-ja, per Lot 2 ne njoftimin per kontrat e ka kërkuar vetem nje sinjalizues për vija të bardha nëpër rrugë, te cilen OE i rekomanduar per kontrat e ka ofruar ne oferten origjinale.
Ne lidhje me pretendimin e OE ankues se OE i rekomanduar per kontrat nuk ka qarkullim bankar sipas kerkeses, eksperti shqyrtues sqaron se ne dosje te tenderit AK-ja, ka kërkuar qe:

Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqshme Autoritetit Kontraktues se qarkullimi i OE gjat tri viteve të fundit (2013, 2014, 2015) ka qen prej jo më pak se: Për loto 2: 980.000,00 €.
Ne ofert OE i rekomanduar per kontratë me saktësisht anëtari i konzorciumit per vitin 2013 i ka 957,264, ndersa per vitin 2014 745,534.94 euro. Ndersa lideri i grupit ka ofruar qarkullim bankar per tri vitet e kërkuara nga NLB banka ne vler prej 239,029.48, ndersa nga raiffeisen banka qarkullim ne vler prej 210,326.99 euro. Andaj sipas nenit 71 te LPP-se, te gjitha kërkesat e vendosura ne dosje te tenderit ne lidhje me nenin 68 te LPP-se, do të aplikohet vetëm ndaj grupit si tërësi dhe jo ndaj anëtarëve individual të grupit, e ne rastin konkret kete kerkes te dosjes se mbulon vetem anetari i konzorciumit.

Ne lidhje me pretendimin e OE ankues, se OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka plotësuar kërkesën ne lidhje me menaxherin e projektit, eksperti shqyrtues sqaron se ne ofertë OE i rekomanduar për kontratë e ka ofruar diplomën, vendimin mbi caktimin e menaxherit, CV-in.

Sqarimi nr.2
Eksperti shqyrtues, sqaron se ankesa e OE ankues ka qen ne shqyrtim ne OSHP, për te cilin është lëshuar edhe një vendim ku OE ankues është shpallur i papërgjegjshëm. OE ankues ne ankesën e parashtruar ne OSHP, ne asnjë pike te saj nuk e argumenton ofertën e tij si te përgjegjshme konform nenit 4.1.26 dhe nenit 111 paragrafit 1.5 dhe 1.8 te LPP-se. Andaj, ankesa e OE ankues nuk i plotëson kushtet e parapara ne dispozitat e lartpërmendura për faktin se me vendim është i papërgjegjshëm dhe se ne asnjë rrethan nuk mund te jet nënshkrues i kësaj kontrate publike.

Mendimi i ekspertit shqyrtues :

- Eksperti shqyrtues bazuar në konstatimet e cekura në ekspertizë mendon që Autoriteti Kontraktues – **Komuna Prizren (KP)**, për aktivitetin e prokurimit **"Shenjëzimi horizontal, vertikal dhe vendosja e barrierave në rrugët e Prizrenit"** – Lot 2 me numër të prokurimit: **622/16/086/511,** i ka respektuar dispozitat e LPP-së.
- Prandaj eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ta aprovojë vendimin e AK-së për dhënie të kontratës dhe propozon që ankesa e OE ankues te hudhet poshtë si e pa lejuar.